

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE KURBIN

Nr. 460 Prot.

Laç, me 26.10.2021

V E N D I M - S H P A L L J E

(Lidhur me ekzekutimin e "Urdherit të Ekzekutimit" të titullit ekzekutiv të debitorit)

Ne Lac sot me date 26.10.2021

Une, Rovena Prenga, me detyre Permbarues Gjyqësore pranë Zyres Permbarimore Kurbin, pasi studiova aktet proceduriale të çeshtjes permbarimore Nr.579 rregj. të vitit 2021 bazuar në Urdherin e ekzekutimit Nr.-- prot Dt .19.07.2021 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë,

KONSTATOVA:

Se në datë 01.10.2021 është depozituar pranë Zyres së Permbarimit kërkesa e kreditorit Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë së bashku me "Urdherin e Ekzekutimit" të Titullit Ekzekutiv (vendim gjyqësor) Nr.291 prot Dt 05.02.2021, të Gjykates së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me palë dhe objekt:

-Kreditor: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

-Debitor: Dife Rrahman Çopani e dtl.15/01/1952 me banim Nd.1,Lgj.4,Lac.

-Me objekt: Shpenzime proceduriale në vlerën 20.300 leke + 2.436 leke për TFP dhe TVSH e saj, në total 22.736 (njetzet e dy mijë e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë) –lekë.

Nga ana e zyre tone permbarimore kanë filluar procedurat në bazë të nenit 515 e vijues të K.Pr.Civile si dhe ligjit 8730 datë 18/01/2001 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Sherbimit Permbarimor Gjyqësor" i ndryshuar për ekzekutimin e detyrueshëm të Titullit Ekzekutiv të sipercituar.

Nga verifikimi i kryer nga ana jone në bashkëpunim me organet kompetente rezulton se debitori Dife Rrahman Çopani e dtl.15/01/1952 me banim Nd.1,Lgj.4,Lac nuk ka marrë dijëni nepermjet sherbimit postar, si rezultat i kesaj bazuar në nenin 133/a ,133/b dhe 144/a si dhe 517 të K.Pr.Civile duhet të behet njoftimi me shpallje publike i debitorit lidhur me detyrimin që ai ka ndaj palës kreditore Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë për Dife Rrahman Çopani që të paguaje detyrimin shpenzime proceduriale 320.300 leke + 2.436 leke për TFP dhe TVSH e saj, në total 22.736 (njetzet e dy mijë e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë) –lekë.

Sa me sipër në mbështetje të Nenit 133/a ,133/b dhe 144/a si dhe 517 të Kodit Procedures Civile, ligjit Nr.8730 datë 18/01/2001 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Sherbimit Permbarimor Gjyqësor", i ndryshuar

V E N D O S A

1-Te kryej njoftimin nepermjet shpalljes publike me afat 20 (njetzet) ditor (duke marrë parasysh edhe komunikimin postar) nga data 26/10/2021 - 14/11/2021 të debitorit; Dife Rrahman Çopani e dtl.15/01/1952 me banim Nd.1,Lgj.4,Lac.

2-Ky vendim perpilohet në disa kopje, ku një kopje afishohet në vendbanimin e fundit të palës debitore, një kopje afishohet në këndin e njoftimeve të kesaj zyre, një kopje dergohet për afishim në ambjentet e Bashkia Kurbin, një kopje dergohet për afishim në ambjentet e Gjykates së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe një kopje i dergohet për publikim në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Permbarimit Tiranë.

3-Kjo shpallje publike ka vlerën e aktit të njoftimit për palën debitore; Dife Rrahman Çopani e dtl.15/01/1952 me banim Nd.1,Lgj.4,Lac.

4-Palë debitore Dife Rrahman Çopani e dtl.15/01/1952 me banim Nd.1,Lgj.4,Lac, duhet të paraqitet pranë Zyres Permbarimore Kurbin me seli në Lgj nr.4,Lac në këtin e parë në ambjentet e Gjykates së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe të marrë kontakt me permbaruesin gjyqësor të çeshtjes permbarimore për t'iu venë në dispozicion aktet permbarimore, pasi me kalimin e ketij afati do të vijohet me ekzekutimin e detyruar sipas parashikimeve të nenit 519 e në vijim të K.Pr.Civile.

U shpall, sot me datë 26.10.2021.

PERMBARUES GJYQËSOR
ROVENA PRENGA

